




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



DATE/A:	29.01.2018
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-DPKI-03-02-4227/17
PËR/ZA/TO:	z. Ramush Haradinaj, Kryeministër Qeveria e Republikës së Kosovës
CC:	Zv.Kryeministrat, Ministrat e Kabinetit Qeveritar, zv.Ministrat, Pjesëmarrës në procesin e votimit
NGA/OD/FROM:	Shaip Havolli, Drejtor Agjencia Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 04/20, datë 20.12.2017

I nderuar Kryeministër z. Haradinaj,

Në mbështetje të Nenit 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.12, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe Nenit 19, paragrafi 1, nën paragrafët 1.5 dhe 1.6, të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Agjencia kundër Korrupsionit ka shqyrtuar rastin me nr. AKK-03-02-4227/17, që lidhet me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.04/20 të datës 20.12.2017, të nxjerrë në mbledhjen e 20-të Qeverisë, për rritjen dhe caktimin e pagave të disa pozitave në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Agjencia Kundër Korrupsionit, në kuadër të kompetencave të saj të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Ligjin Nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (më tutje Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), sipas Nenit 19, paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, *"bën këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave"*.

Po ashtu Agjencia Kundër Korrupsionit, sipas Nenit 18, paragrafi 2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit *“mund ta filloj procedurën në bazë të lajmërimit të ndonjë personi tjetër apo lajmërimit anonim”*.

Me këtë rast, Agjencia Kundër Korrupsionit në cilësinë e autoritetit qendror për mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, sipas Nenit 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, ofron opinione dhe ndërmerr të gjitha masat tjera ligjore me qëllim të parandalimit të konfliktit të interesit dhe të korrupsionit në përgjithësi. Në përputhje me këtë, Agjencia Kundër Korrupsionit, pas vlerësimit të të gjitha rrethanave lidhur me rastin, ofron këtë:

OPINION

- I. Është shfaqur situata e konfliktit të interesit “rast për rast” te votimi (aprovimi), dhe nënshkrimi i Vendimit të Qeverisë nr.04/20 për rritjen e pagave të disa pozitave në kabinetin qeveritar.
- II. Zyrtarët e lartë publikë (Kryeministri, zv.Kryeministrat, Ministrat dhe zv.Ministrat) që kanë votuar këtë Vendim kanë vepruar në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konkretisht me konfliktin e interesit “rast për rast”, dispozitat e caktuara që rregullojnë “Veprimet e ndaluara për zyrtarin e lartë”, si dhe me shumicën e dispozitave që përcaktojnë “Parimet e veprimit dhe mos veprimit të zyrtarit të lartë publik”.
- III. Për të evituar konfliktin e interesit “rast për rast”, Agjencia kundër Korrupsionit jep rekomandimet e veta.

ARSYETIM

Konstatimi i Agjencisë Kundër Korrupsionit si në këtë dispozitiv, është i bazuar në Ligjin Nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, informacioneve të siguruar nga Zyra e Kryeministrit, analizës së bazës tjetër ligjore në lidhje me këtë çështje, konsultimeve dhe takimeve me zyrtarë të autorizuar nga Zyra e Kryeministrit, të përfshirë në këtë proces.

I.

Zyrtarët e lartë publik janë të obliguar sa herë që kanë njohuri të ekzistimit të konfliktit të interesit privat të tyre, ta bëjnë deklarinimin paraprak.

Konflikti i interesi “rast për rast” është i rregulluar në dispozitat ligjore të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Zyrtarët e lartë publik që të parandalojnë konfliktin e interesit “rast për rast” duhet të bazohen në tre paragrafët e nenit 13, si në vijim:

1. *“Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat lidhur me vendimarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit”.*

2. *Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur.*

3. *Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimarrje për ndonjë çështje të caktuar.*

II.

Me qëllim që zyrtarët e lartë publik të jenë në mbrojtje të interesit të përgjithshëm, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ka përcaktuar dispozita tjera me të cilat janë paraparë veprimet e ndaluara të zyrtarëve të lartë. Neni 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.9, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ndërlidhet me rastin konkret dhe shprehimisht parasheh si në vijim:

“Gjatë ushtrimit të funksionit publik, zyrtarit të lartë i ndalohet:

1.9. të ndërmarr veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten interesit personal të tij apo interesit të personave të afërt apo të besueshëm”.

Poashtu, sipas Nenit 7 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit përcaktohen parimet e veprimit dhe mos veprimit të zyrtarit të lartë, gjatë ushtrimit të funksionit publik, si në vijim:

1. Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik duhet të veproj në mbrojtje të interesit publik dhe nuk ka të drejtë që interesin e tij privat ta vërë para interesit publik, për mbrojtjen e të cilit është zgjedhur apo emëruar.

2. Zyrtari i lartë ushtron funksionin e tij në pajtim me ligjin dhe kodin e mirësjelljes.

3. Zyrtari i lartë duhet ta kryej punën e tij me ndershmëri, ndërgjegje, paanshmëri, të ruajë autoritetin e zyrtarit të lartë dhe institucionit dhe me punën e tij të rrisë besimin e qytetarëve në institucione.

4. Zyrtari i lartë përgjigjet personalisht për veprimet e tij gjatë ushtrimit të funksionit në të cilin është emëruar apo zgjedhur nga institucioni apo qytetarët.

5. Zyrtari i lartë nuk ka të drejtë të shfrytëzojë funksionin publik për përfitim të kundërligjshëm për vete apo për të tjerët.

8. Zyrtari i lartë nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm.

9. Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij duhet të veprojë me transparencë duke respektuar të drejtën e organeve përfaqësuese dhe të drejtën e qytetarëve që të informohen për veprimet e zyrtarit si personalitet publik.

III.

Bazuar në shqyrtimin dhe analizimin e gjendjes, Agjencia Kundër Korrupsionit e ka trajtuar ekskluzivisht çështjen e konfliktit të interesit lidhur me atë se ka apo nuk ka konflikt interesi të zyrtarëve të lartë publik në procesin e nxjerrjes së Vendimit të Qeverisë për rritjen e pagave të kabinetit qeveritar.

Nga ky këndvështrim, gjithnjë duke u bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi (Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), Agjencia Kundër Korrupsionit, konstaton se konflikti i interesit është shkaktuar vetëm për zyrtarët e lartë që kanë qenë pjesë e procesit të vendimmarrjes.

Vendimi i Qeverisë i datës Nr. 04/20, datë 20.12.2017, nuk mund të cilësohet si konflikt i interesit për të gjithë ata të cilët janë përfitues nga nxjerrja e këtij vendimi. Konflikti i interesit është paraqitur tek zyrtarët e lartë të cilët me votën e tyre kanë ndikuar që Vendimi të jetë në interes të tyre për përfitime personale.

Rrjedhimisht, Agjencia Kundër Korrupsionit, rastin në fjalë nuk e ka trajtuar në aspekt të kompetencës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, të drejtën apo jo për rritje të pagave për atë sektor, mirëpo çështja është trajtuar vetëm në aspekt të procedurës dhe mënyrës së nxjerrjes së Vendimit, duke e vlerësuar kështu me konflikt të interesit vetëm pjesën që kanë votuar, aprovuar dhe nënshkruar.

Prandaj, përmes këtij Opinoni, Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që Vendimi të kthehet në rishqyrtim, duke shfrytëzuar mënyra tjera ligjore të cilat nuk bien ndesh me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe legjislacionin tjetër relevant në fuqi.

Parandalimi i konfliktit të interesit në radhë të parë është obligim i vet zyrtarit të lartë publik, më pas i institucionit ku zyrtari i lartë publik e ushtron funksionin e tij publik dhe në fund edhe Agjencisë kundër Korrupsionit (Neni 8, paragrafet 1, 2, 3, 5 dhe 6 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit). Meqenëse përgjegjësia është individuale (Neni 7, paragrafi 4 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), Agjencia Kundër Korrupsionit është e obliguar që ndaj secilit zyrtar të lartë publik, pjesëmarrës në vendimmarrje, të inicoj procedurat individuale sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Agjencia Kundër Korrupsionit ju falenderon për bashkëpunimin.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	29.01.2018
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-DPKI-03-02-4227/17
PËR/ZA/TO:	g. Ramush Haradinaj, Premijer Vlada Republike Kosovo
CC:	Zm.Premijera, Ministri Kabineta Vlade, zm.Ministri, Učesnici u procesu glasanja
NGA/OD/FROM:	Shaip Havolli, Direktor Agencija Protiv Korupcije 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Mišljenje vezano sa Odlukom Vlade Republike Kosova, Br. 04/20, dana 20.12.2017



Agencija Protiv Korupcije, u okviru svojih nadležnosti predviđenih Zakonom Br. 03/L-159 za Agenciju Protiv Korupcije i Zakonom Br. 04/L-051 o Sprečavanju Sukoba Interesa u Vršnju Javne Funkcije, (dalje Zakon za Sprečavanje Sukoba Interesa), u skladu sa Članom 19, stav 1, tačka 1.5, *“savetovanje posebnih visokih zvaničnika pretpostavljenih, visokih institucija, na njihov zahtev, za određene slučajeve pojavljivanja sukoba interesa, i za pitanja etike u vezi sa istima, kao i registrovanje slučajeva do slučaja interesa”*.

Takođe, Agencija Protiv Korupcije, prema Članu 18, stav 2, Zakona o Sprečavanju Sukoba Interesa *“može da počne proceduru na osnovu obaveštavanja nekog drugog lica ili anonimnog prijavljivanja”*.

Ovom prilikom, Agencija Protiv Korupcije u svojstvu centralnog organa za nadgledanje i sprovođenje odredaba Zakona za Sprečavanje Sukoba Interesa, prema Članu 19, stav 1, tačka 1.6, pruža mišljenja i preduzima sve druge zakonske mere sa ciljem suzbijanja sukoba interesa i korupcije uopšte. U skladu sa ovim, Agencija Protiv Korupcije, nakon procene svih okolnosti u vezi sa slučajem, daje ovo:

MIŠLJENJE

1. Pojavila se situacija sukoba interesa "od slučaja do slučaja" pri glasanju (odobrenje), i i i i potpisa odluke Vlade br. 04/20 o povećanju plata pojedinih pozicija u kabinetu vlade.
2. Visoki javni zvaničnici (Premijer, zm. Premijeri, Ministri i zm. Ministri) koji su glasali ovu Odluku su prekršili Zakon o Sprječavanju Sukoba Interesa, konkretno sukob interesa "od slučaja do slučaja" određene odredbe koje regulišu "Zabranjene akcije za visokog zvaničnika", kao i sa većinom odredaba koje definišu "Principi akcije i neaktivnosti višokog javnog zvaničnika"
3. Da bi se izbegao sukob interesa "od slučaja do slučaja", Agencija Protiv Korupcije daje svoje preporuke.

OBRAZLOŽENJE

Konstatacija Agencije Protiv Korupcije, kao u ovoj odredbi, zasnovano je na Zakonu Br. 04/L-051 o Sprečavanju Sukoba Interesa, informacije pružane iz Kancelarije Premijera, analiza druge pravne osnove po ovom pitanju, konsultacije i sastanci sa ovlašćenim službenicima Kancelarije Premijera, koji su uključeni u ovaj proces.

I.

Visoki javni zvaničnici su obavezni da, kad god imaju znanje za postojanje sopstvenog privatnog sukoba interesa, da daju prethodnu izjavu.

Sukob interesa "od slučaja do slučaja" reguliše se zakonskim odredbama Zakona o Sprječavanju Sukoba Interesa.

Visoki javni zvaničnici da bi sprečili sukob interesa "od slučaja do slučaja" treba da se zasnivaju na tri stavka člana 13, kao sledeće:

1. *Svaki visoki zvaničnik tokom vršenja njegove javne funkcije, na osnovu njegovih saznanja i u poverenju, se obavezuje da sam izvrši prethodno prijavljivanje, od slučaja do slučaja*

postojanja njegove privatne egzistencije u vezi sa odlučivanjem u nekoj određenoj stvari, koje može da bude razlog za pojavljivanja nekog sukoba interesa”.

2. “Prijavlivanje od slučaj do slučaja privatnih interesa se vrši se uvek od visokog zvaničnika, kada se to traži od pretpostavljenog ili nadzorne institucije. Prijavlivanje kao pravilo treba da se traži i učini prethodno. Kada to nije moguće ili kada nije se dogodilo, prijavljivanje treba da se traži da se učini što moguće brže”.

3. “Samo prijavljivanje kao pravilo se vrši pismeno, kada visoki zvaničnik se obuhvata na neko odlučivanje za neko određeno pitanje”.

II.

Da bi visoki javni zvaničnici bili u odbrani opšteg interesa, Zakon o Sprečavanju Sukoba Interesa propisao je druge odredbe koje zabranjuju zabranjene radnje viših službenika. Član 9, stav 1, podstav 1.9, Zakona o Sprječavanju Sukoba Interesa odnosi se na konkretni slučaj i izričito predviđa sledeće:

“Tokom vršenja javne funkcije visokom javnom zvaničniku se zabranjuje:

1.9. da preduzme postupke koji na neki način bi prilagodili ličnom njegovom interesu ili interesu bližnjih ili poverljivih lica;”.

Takođe, prema članu 7 Zakona o Sprječavanju Sukoba Interesa, principi postupanja i neoperativnosti visokog zvaničnika tokom vršenja javne funkcije su definisani kako sledi:

1. Visoki zvaničnik tokom vršenja javne funkcije treba da postupa u odbrani javnog interesa i nema pravo da njegov privatni interes da stavlja ispred javnog interesa., za zaštitu kojeg je izabran ili imenovan.

2. Visoki zvaničnik vrši svoju funkciju saglasno sa zakonom i kodeksom dobrog ponašanja.

3. Visoki zvaničnik da vrši svoju dužnost časno, savesno, nepristrasno, da sačuva autoritet visokog zvaničnika i institucije i da njegovim radom povećava poverenje građana u institucije.

4. Visoki zvaničnik lično odgovara za njegove postupke tokom vršenja funkcije na koju je imenovan ili izabran od institucije ili građana.

5. Visoki zvaničnik nema pravo da korsiti javnu funkciju za protivzakonitu dobit za sebe ili za druge.

6. Visoki zvaničnik tokom vršenja javne funkcije nema pravo da stvara odnose zavisnosti od drugih lica koji bi mogli da utiču na nepristrasnost i izražavanju slobodne volje na odlučivanje.

7. Visoki zvaničnik za posao koji obavlja u vršenju funkcije nema pravo da prima ili da traži drugu nagradu osim naknade koja mu se dozvoljava na osnovu zakonskih odredaba na snagu.

8. Visoki zvaničnik ne treba da se dozvoli da njegovi priivlatni interesi dolaze u sukob sa njegovom funkcijom. On treba da izbegava sukobu interesa nezavisno ukoliko on je realan, ili moguć.

9. Visoki zvaničnik tokom vršenja njegove funkcije treba da postupa transparentno poštujući prava predstavničkih organa i prava građana da se informišu za postupanja zvaničnika kao javne ličnosti.

III.

Na osnovu pregleda i analize stanja, Agencija Protiv Korupcije tretirala je isključivo pitanje sukoba interesa u vezi sa tim da ima ili nema kod visokih javnih zvaničnika sukob interesa u procesu sa izdatom Odlukom Vlade da poveća plate kancelarije.

Iz ove perspektive, uvek na osnovu odgovarajućeg zakonodavstva (Zakon o Sprečavanju Sukoba Interesa), Agencija Protiv Korupcije, zaključuje da sukob interesa je izazvan samo za visoke zvaničnike koji su bili deo procesa donošenja odluka.

Odluka Vlade Br. 20/04, datum 12.20.2017, ne može se smatrati kao sukob interesa za sve one koji su korisnici donošenja ove odluke. Sukob interesa je predstavljen kod visokih zvaničnika koji su uticali svojim glasom da Odluka bude u njihovom interesu radi lične koristi.

Shodno tome, Agencija za Protiv Korupcije, slučaj nije tretirao u pogledu nadležnosti Vlade Republike Kosova, prava ili da se ne poveća plate za taj sektor, ali problem je tretiran samo u smislu procedure i metode izdavanja odluke, s'obzirom da je sukob interesa samo deo koji je glasao, odobrio i potpisao.

S'toga, kroz ovo Mišljenje, Agencija Protiv Korupcije preporučuje tu Odluku nazad na ponovno razmatranje od strane drugih pravnih načina da nisu u suprotnosti sa Zakonom o Sprečavanju Sukoba Interesa i drugim relevantnim zakonima na snazi.

Sprečavanje sukoba interesa na prvom mestu je obaveza visokih javnih zvaničnika, onda je institucija u kojoj visoki javni zvaničnik vrši javnu funkciju i, na kraju Agencija Protiv Korupcije (Član 8, stav 1, 2, 3 5 i 6 Zakona o Sprečavanju Sukoba Interesa). Pošto je odgovornost

individualna (Član 7, stav 4 Zakona o Sprečavanju Sukoba Interesa), Agencija Protiv Korupcije je dužna da za visoke javne zvaničnike, koji su učestvovali u odluci pokrene postupak pojedinačne prema Zakonu o Sprečavanju Sukoba Interesa i Krivičnog Zakona Republike Kosovo.

Agencija Protiv Korupcije Vam se zahvaljuje na saradnji.

S poštovanjem,